



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 12/2019) dhe nenit 40 dhe 41 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, duke vepruar pas denoncimit për korrupsion nga parashtruesi nga, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK) në vazhdimin e seancës së 42-të të mbajtur me datë 11.12.2020, morri

VENDIM

Procedura për lëndën numër 12-2351 nga viti 2020, e formuar në bazë të denoncimit me numër 12-2351/1 me datë 06.07.2020, dorëzuar nga parashtruesi nga,
NDËRPRITET.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nuk ka elemente për veprim të metutjeshëm për lëndën me numër 12-2351 nga viti 2020, për rastin e lëndës veprohet nga organ tjetër kompetent.

Lënda me numër 12-2351 nga viti 2020, të mbyllet dhe të arkivohet.

Deri tek parashtruesi të dorëzohet Vendimi i KSHPK, me sqarimin.

Vendimi i Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit, me sqarimin – në formë të depersonalizuar, të publikohet në web-faqen e Komisioni shtetëror në afat prej 5 (pesë) ditë nga dita e marrjes së vendimit.

Sqarim

Lënda me numër 12-2351 nga viti 2020 është formuar në bazë të denoncimit me numër 12-2351/1 nga viti 06.07.2020, dorëzuar deri në KSHPK nga parashtruesi nga

Në denoncimin e pranuar janë treguar akuza kundër Fondit për SPIM – Njësia për vlerësim të aftësisë së punës Shkup, përshkak se nuk ka vepruar për lëndën të dorëzuar nga ana e Fondit për SPIM – shërbimi profesional – filiala me datë 28.01.2020.

Gjatë rishikimit të rastit të lëndë, Komisioni shtetëror i merr parasyshë akuzat e parashtruesit dhe me qëllim të caktimit të gjendjes së përgjithshme faktike pas formimit të lëndës, dorëzoi kërkesë deri në Fondin SPIM – Njësia për vlerësim të aftësisë së punës - Shkup për mbledhje të të dhënave, informacioneve dhe dokumentacionit në lidhje me rastin e lëndës.

Në kërkesë të KSHPK janë dorëzuar të dhënat e nevojshme dhe informacionet dhe pas rishikimit të dokumentacionit të plotë për rastin e lëndës është caktuar gjendja faktike vijuese:

- Në rastin konkret bëhet fjalë për lëndë e cilia është udhëhequr në Fondin SPIM – shërbimi profesional filiala, në të cilin është marrë vendim me datë 20.03.2018 me të cilën parashtruesi i denoncimit ka fituar të drejtën e pensionit invalidor në vlerë prej 18.829,00 denarë, llogaritur nga data 15.12.2019.

I pakënaqur nga vendimi i marrë, parashtruesi dërgoi ankesë deri në Komisionin shtetëror për vendime në procedurë administrative dhe procedurë për marrëdhënje pune të shkallës së dytë e cila me datë 15.11.2018 morri vendim me të cilën ia rrefuzoi ankesën si të pabazë. Pas kësaj parashtruesi i denoncimit dha padi e cila është vulosur si konflikt (mosmarrveshje) para

Gjykatës administrative në RMV e cila ka qenë miratuar nga gjyqi dhe me verdikt me datë 06.11.2019, lënda është kthyer deri në Komisionin shtetëror për vendosje në procedurë administrative dhe procedura për marrdhënje pune, në shkallën e dytë për procedurë të përsëritur, dhe e cila morri vnedim me datë 6.01.2020 me të cilën ankesa e parashtruesit është miratuar dhe lënda është kthyer në rishikim dhe vendimmarje të përsërit në Fondin SPIM – shërbimi profesional – Filiala, me udhëzime të dhëna për vendimmarrje të vendimit ligjësor. Vendimi është dorëzuar deri në Fondin me datë 23.01.2020.

Me datë 28.05.2020, parashtruesi i denoncimit dorëzoi Urgencë deri në Fondin SPIM – Filiala shërbimi profesional, për veprim dhe procedurë për lëndën e tij, gjegjësisht për Vendimin e Komisionit shtetëror për vendosje në procedurë administrative dhe procedurë për marrdhënje pune të shkallë së dytë, me paralajmërim se do të drejtohet edhe deri në Inspektoratin shtetëror administrativ nëse nuk merr përgjigje për kërkesën e vet, kurse për shkak të procedurës së mosazhurar të fondit. Me datë 29.05.2020 morri përgjigje se lënda është dërguar në procedurë kompetente deri në Fondin për SPIM – Njësia për vlerësim të aftësisë së punës - Shkup, me datë 28.01.2020 dhe se ende nuk i është kthyer prapë.

- Me datë 01.09.2020 me kërkesë të KSHPK është dorëzuar lajmërim deri në Fondin për SPIM me të cilën lajmërohen se: kërkesa e lëndës për realizim të të drejtës për pension invalidor është dorëzuar me datë 27.10.2014; nga ana e Komisionit për vlerësim të aftësisë për punë është dorëzuar Vendim me të cilën vërtetoi se nuk ekziston as paaftësi e përgjithshme as profesionale për punë, kurse për të cilat kërkuesi i pakënaqur nga përfundimi ka bërë disaherë procedura të shkalë së dytë dhe procedurë para Gjykatës administrative; është vepruar edhe nga Komisioni për revizion pran Ministrisë për punë dhe politikë sociale e cila me datë 15.12.2016 caktoi se tek i emërtuari ekziston paaftësi e përgjithshme përpunë e shkaktuar si rezultat i sëmundjes llogaritur nga 02.12.2016; me këtë gjendje për herë të parë është caktuar ekzistimi i paaftësisë së përgjithshme me të drejtë të pensionit dhe vendim me datë 03.01.2017 të emërtuarit iu miratua e drejta për pension invalidor llogaritur nga data 02.12.2016; dhe kundër këtij vendimi i emërtuari bëri procedurë të shkallës së dytë sepse u ankua për datën e fillimi të paaftësive, dhe me përmbushje të vendimit të shkallë së dytë, përsëri me Mendim të komisionit për revizion me datë 28.12.2017, është caktuar ekzistimi i paaftësisë së përgjithshme prej 81% llogaritur nga data 15.12.2016 dhe me vendim me datë 20.03.2018 iu është miratuar e drejta për pension invalidor llogaritur nga data 15.12.2019; kundër këtij vendimi dhe lënda është kthyer në procedurë të përsëritur; në Verdiktin janë dhënë kahje se janë marrë dy gjendje të ndryshme me data të ndryshme për fillimin e invaliditetit për diagnozë të njëjtë dhe dokumentacion i njëjt mjekësor, i cili ka qenë ofruar/dorëzuar në lëndën kurse komisioni kompetent nuk sqaroi nga cilat shkaqe janë dhënë data të ndryshme të invaliditetit. Për shkak të së cilës në procedurën e përsëritur në mënyrë të drejtë të llogaritet gjendja faktike; në përputhje me neni 131 paragrafi 5 nga LSPI, Komisioni për vlerësim të aftësisë për punë dhe Komisioni për kontrollim të obliguar kan qenë të obliguar të veprojnë sipas Mendimit të dhënë në procedurë për revizion dhe të japin gjendje të re, vlerësim dhe mendim gjegjësisht të japin gjendje në përputhje me mendimin e dhënë nga Komisioni për revizion.

Në fund, Fondi SPIM lajmëron se procedura për rastin e lëndë ka qenë ende në vazhdim dhe nuk ka qenë përfunduar me arsye që Komisioni për vlerësim të aftësive për punë përshkak të gjendje me pandeminë Covid-19 gjatë kohës së gjendje së jashtëzakonshe nuk ka punuar

me palë dhe tash me fillimin e punës i emërtuari do të merr ftesë për kontrollim pa ndërmjetësues në afatin më të shpejtë të mundshëm.

Në bazë të gjendje faktike të caktuar, KSHPK konstaton se nga ana e parashtruesit të denoncimit janë përdorur të gjitha mjetet juridike në lidhje me rastin e lëndës dhe se nga ana e të gjitha organeve kompetente deri te të cilët është drejtuar kanë vepruar në kuadër të kompetencave të veta, kurse për rastin e lëndës bëhet procedurë para organi tjetër kompetent, Komisioni për vlerësim të aftësive për punë pranë Fondit për SPIM, e cila procedurë ene nuk është përfunduar. Duke pasë parasyshë të konstatuarën, KSHPK vlerëson se në rastin e lëndës veprohet nga ana e organi tjetër kompetent dhe se Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm për rastin e lëndës, procedura të ndërpritet, kurse lënda të mbyllet dhe të arkivohet.

Duke pasë parasyshë të theksuarën më lartë, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

Është vendosur me datë 11 Dhjetor 2020, me numrë 12-2351/4

Dorëzuar deri tek: Arkiva dhe parashtruesi

Pas përfundimit të KSHPK

Punoi: J. C., këshilltarë

Miratoi: B. I., Kryetarë e KSHPK

KOMISIONI SHTETËROР ПЁР
PARANDALIM TË KORRUPTIONIT
Kyetar: Biljana Ivanovska